

VA.NI.CA. Holding

M51512006E

Date 01/09/2025

KONTRATË DHURIMI

Sot, më date 01/09/2025, palët e mëposhtme lidhin këtë kontratë dhurimi:

DHURUESI

- **Z. Fabio Petrauskas**, i datëlindjes 30/06/1979, shtetas italian, lindur në Romë dhe banues ne Romë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit me Nr. CA85770TK.

PRANUESI



- **Zj. Sandra Petrauskiene**, e datëlindjes 28/03/1983, shtetase shqiptare, lindur në Klaipeda dhe banuese ne Romë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtese e kartes se identitetit me Nr. CA08647FO.

Të lartëpërmendurit janë madhorë me zotësi të plota juridike të cilët hartojnë këtë kontratë dhurimi të kuotave si më poshtë:

Dhuruesi **Fabio Petrauskas** është ortak i shoqërisë VA.NI.CA Holding sh.p.k. një shoqëri e regjistruar në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi me NUIS M51512006E, ku zotëron 1 (një) kuote të kapitalit të kësaj shoqërie në masën 25%. Nga kuota që zotëron Fabio Petrauskas në shoqërinë e mësipërme i dhuron • Zj. Sandra Petrauskiene 1 (një) kuotë të shoqërisë me vlerë nominale 25,000 (njëzete e pesemijë) lekë, e cila përfaqëson 25% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Pas përfundimit të dhurimin, shpërndarja e kuotave dhe kontributi i ortakëve në shoqëri do të jetë si më poshtë:

- **Z. David Ferrari** do të kontribuojë në Shoqëri shumën prej 24,000 (njëzete e katermijë) lekë, çka rezulton në zotërimin nga ana e tij e 1 (një) kuote të shoqërisë me vlerë 24,000 (njëzete e katermijë) lekë, e cila përfaqëson 24 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- **Z. Erasmo Cipriani** do të kontribuojë në Shoqëri shumën prej 24,000 (njëzete e katermijë) lekë, çka rezulton në zotërimin nga ana e tij e 1 (një) kuote të shoqërisë me vlerë 24,000 (njëzete e katermijë) lekë, e cila përfaqëson 24 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- **Z. Sandra Petrauskiene** do të kontribuojë në Shoqëri shumën prej 25,000 (njëzete e pesemijë) lekë, çka rezulton në zotërimin nga ana e tij e 1 (një) kuote të shoqërisë me vlerë 25,000 (njëzete e pesemijë) lekë, e cila përfaqëson 25 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- **Zj. Dorjana Kafeja** do të kontribuojë në Shoqëri shumën prej 3,000 (tremijë) lekë, çka rezulton në zotërimin nga ana e tij e 1 (një) kuote të shoqërisë me vlerë 3,000 (tremijë) lekë, e cila përfaqëson 3 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- **Z. Alentin Dervishi** do të kontribuojë në Shoqëri shumën prej 24,000 (njëzete e katermijë) lekë, çka rezulton në zotërimin nga ana e tij e 1 (një)



VA.NI.CA. Holding

M51512006E

kuote të shoqërisë me vlerë 24,000 (njëzete e katërmijë) lekë, e cila përfaqëson 24 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

Pranuesja e dhurimit deklaron se pranon dhurimin e pjesës së kapitalit themeltar që i dhurohet nga **Z. Fabio Petrauskas** në shoqërinë VA.NI.CA. Holding sh.p.k., dhurim ky që i bëhet pa ndonjë shpërblim material apo monetar.

Me lidhjen e kësaj Kontratë Dhurimi, palët në të marrin dijeni se dhuruesi e humbet të drejtën e pronësisë të pjesës së kapitalit të dhuruar në shoqërinë VA.NI.CA. Holding sh.p.k. dhe nuk ka asnjë të drejtë ligjore mbi kapitalin e dhuruar. Kjo kontratë do të regjistrohet pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.

Kontrata e dhurimit u redaktua në bazë të nenit 761 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

Palët deklaruan se ky dhurim është bërë me vullnet të plotë dhe pa kundërshtpërblim.

Kontrata e mësipërme si u lexua nga ne palët dhe u pa se në të është shprehur dëshira e vullneti i lirë dhe i plotë e nënshkruajnë pa vërejtje.

Kontrata e dhurimit u hartua në gjuhën shqipe dhe iu përkthye e lexua në gjuhën italiane nga **Zj. Dorjana Kafeja** për Ortakët e shoqërisë, të cilët nuk e zotërojnë gjuhën shqipe. Pasi u shqyrtua, dokumenti u konsiderua në përputhje me vullnetin e tyre dhe u nënshkrua pa asnjë vërejtje.

Dhuruesi
Fabio Petrauskas



Pranuesi i Dhurimit
Sandra Petrauskiene

